



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:103464

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05519473

KA.nr.487/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “NSh Sejdo-Farm” (A.V. BI) me NUI 810730805 dhe seli në rrugën Hasan Prishtina p.nr. në Obiliq, i cili sipas prokurës përfaqësohet nga avokati V.Rr. me seli në rrugën Nekibe Kelmendi p.nr. në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 15.03.2024 në të cilën mori pjesë përfaqësuesi i paditësit dhe përfaqësuesi i të paditurit, më 21 mars 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Hedhet poshtë padia e paditësit “NSh Sejdo-Farm” (A.V. BI) me NUI 810730805 kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktit administrativ nr. 10/AI-011-20 të datës 11.06.2020 me nr. të protokollit 05-3484 të Inspektoratit Farmaceutik.
- II. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit “NSh Sejdo-Farm” (A.V. BI) me NUI 810730805 kundër të paditurit Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, anulohet akti administrativ nr. 10/K-56-20 të datës 21.07.2020 me nr. prot. 05-3484/3 të Kryeinspektorit Shëndetësor, çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te i padituri Ministria e Shëndetësisë, Kryeinspektori Shëndetësor, ashtu që në afat prej tridhjetë (30) ditëve në ri procedurë të nxjerrë akt të ri administrativ për ankesën e paditësit sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 27.08.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e akteve administrative nr. 10/AI-011-20 të datës 11.06.2020 me nr. të protokollit 05-3484 të Inspektoratit Farmaceutik dhe nr. 10/K-56-20 të datës 21.07.2020 me nr. prot. 05-3484/3 të Kryeinspektorit Shëndetësor, si dhe lënda të kthehet në rivendosje te organi administrativ.
2. Duke u nisur nga fakti se sipas nenit 5 para. 2 të Ligjit 04/L190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale (këtu e tutje LPPM), Inspektorati Farmaceutik është strukturë organizative e Inspektoratit Shëndetësor, dhe të dytë funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, atëherë faktin se me padi është përfshirë Ministria e Drejtësisë, Inspektorati Farmaceutik gjykata e trajtoi si padi ndaj tërë Inspektoratit Shëndetësor në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.
3. Paditësi në padi por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka pretenduar se aktet administrative të goditura nuk e kanë vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sepse në momentin e inspektimit barnatorja vetëm se ishte e mbyllur, meqë orari i punës kishte përfunduar 30 minuta më herët. Ka shtuar se për shkak të ndërprerjes së rrymës rreth orës 19:00 farmacisti përgjegjës paraprakisht ishte liruar nga orari i punës dhe ishte mbyllur barnatorja, ndërsa pronari në momentin e inspektimit ishte kthyer në barnatore me qëllim që t'i heq instalimet nga prizat e rrymës, për shkak se në ato momenti kishte ndërprerje të rrymës. Tutje, ka deklaruar se vendimet e goditura janë në kundërshtim me të drejtën materiale, sepse neni 37 para. 3 i LPPM-së e ka paraparë mundësinë që Inspektorati Farmaceutik të shqiptoj gjoba deri në 1000€, ndërsa neni 16 para. 2.1 i udhëzimit administrativ 11/2015 ka paraparë që gjoba duhet të jetë 2000€ dhe lënda të dërgohet në gjykatë.
4. I Padituri me përgjigjen në padi, por edhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit duke theksuar se me asnjë provë nuk janë provuar deklaratimet e Paditësit, duke shtuar se Paditësi nuk e ka bashkëngjitur kontratën e punës të farmacistit të licencuar me qëllim që të vërtetohet orari i punës së tij. Sipas tij, vendimet e atakuar janë të drejtë dhe të ligjshëm, me të cilët është konstatuar drejtë gjendjen faktike, është dhënë arsyetimin konform nenit 48 të LPPA-së si dhe dispozitivi i tij është konform këtij ligji.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

5. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e provave, me përjashtim të dëgjimit të pronarit të Paditësit. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi numër 10/K-56-20 i datës 21.07.2020 i Inspektoratit Shëndetësorë në shkallën e dytë; ankesa e numër të protokollit 053484/2 e datës 26.06.2020 e parashtruar nga paditësi; vendimi me numër 10/AI -011-20 i datës 11.06.2020 i Inspektoratit Shëndetësorë si shkallë e parë; fatura me numër serik 0000507 e lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë; procesverbali mbi inspektimin e kryer me numër rendor 01142 i datës 29.05.2020;
6. Gjykata e refuzoi dëgjimin e z. A.V., si pronar i Paditësit, meqenëse gati e gjithë gjendja faktike nuk ishte kontestuese mes palëve, gjegjësisht nuk ishte kontestuese se barnatorja ishte inspektuar në orën 20:30 ndërsa në atë kohë në hapësirat e barnatores nuk gjendej farmacisti i licencuar. Kontestuese ishte vetëm fakti se a është kryer inspektimi gjatë orarit të punës apo jo, prandaj gjykata duke u bazuar në faktin se A.V. do të deklaronte atë që e ka shkruar në padinë e tij lëndore, vlerësoi jo të rëndësishëm deklaratën e dhe refuzoi dëgjimin e tij.
7. Në bazë këtyre provave gjykata konstaton se Inspektorati i Farmaceutik më 29.05.2020 në orën 20:30 e kishte inspektuar lokalit të Paditësit në Prishtinë dhe mes tjerash kishte konstatuar që nuk kishte qenë prezent farmacisti licencuar ose ai zëvendësues, si dhe kishte urdhëruar që barnatorja të mbyllet dhe të mos operoj pa prezencën e farmacistit i licencuar. Gjatë inspektimit i pranishëm kishte qenë A.V., si pronar i lokalit dhe procesverbalin e inspektimit e kishte nënshkruar pa vërejtje. Këto fakte nuk ishin kontestuese mes palëve, por vërtetohen edhe nga procesverbali mbi inspektimin me numër rendor 01142 i datës 29.05.2020.
8. Më 11.06.2020 Inspektorati Farmaceutik e kishte nxjerrë aktin administrativ 10/A1-001-20 me numër të protokollit 05-3484 me të cilin e kishte gjobitur me 1000€ Paditësin për shkak të mungesës së farmacistit përgjegjës ose zëvendësues gjatë orarit të punës. Në arsyetim të këtij vendimi nuk janë dhënë arsye lidhur me përshtatshmërinë e lartësisë së gjobës së shqiptuar. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes aktit administrativ të sapo cekur.
9. Më 26.06.2020 Paditësi kishte ushtruar ankesë ndaj aktit administrativ të cekur në pasuesin e mësipërm me pretendimin se në kohën e inspektimit barnatorja e kishte

përfunduar orarin e punës, ndërsa Kryeinspektori Shëndetësor përmes aktit administrativ nr. 10/K-56-20 të datës 21.07.2020 të protokolluar me numër 05-3484/3 e kishte refuzuar ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar aktin administrativ të ankimuar. As në arsyetim të këtij vendimi nuk janë dhënë arsye lidhur me përshtatshmërinë e lartësisë së gjobës së shqiptuar, si dhe nuk ishin dhënë sqarime lidhur me pretendimet ankimore të Paditësit. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes aktit administrativ të sapo cekur.

III. Vlerësimi meritor i rastit

10. Gjykata në rend të parë e vlerësoi padinë e Paditësit me të cilën është goditur vendimi nr. 10/AI-011-20 i datës 11.06.2020 me nr. të protokollit 05-3484 të Inspektoratit Farmaceutik dhe gjeti se ajo është e palejueshme.
11. Neni 13 i LKA-së e ka rregulluar se cili akt administrativ i procedurës administrative mund të goditet me padi. Kështu, në para. 1 të nenit 13 të LKA-së parashihet se *“Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë”*, ndërsa para. 2 i po të njëjtit nen ka përcaktuar se *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar”*. Sipas këtyre dispozitave juridike, vetëm akti administrativ përfundimtar i nxjerr në shkallën e dytë të procedurës administrative mund të jetë objekt për shqyrtimin e ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa akti administrativ i shkallës së parë përjashtimisht mund të jetë objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ vetëm nëse ndaj tij nuk lejohet ankesa.
12. Në rastin konkret, vendimi nr. 10/AI-011-20 i datës 11.06.2020 me nr. të protokollit 05-3484 i Inspektoratit Farmaceutik është akt administrativ i shkallës së parë dhe ndaj tij ka qenë e lejuar ankesa, e madje është ushtruar ankesë në procedurë administrative. Kjo situatë është e rregulluar me nenin 34 para. 1 nënpara. 1.4 të LKA-së, sipas të cilit *“Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se: (...) 1.4. kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;”*.
13. Prandaj, për këtë gjykatë padia e Paditësit me të cilin e ka goditur aktin administrativ të shkallës së parë është e palejueshme, rrjedhimisht në bazë të nenit 34 para. 1 dhe 2 të

LKA-së, në lidhje me nenin 13 para. 1 dhe 2 të LKA-së e hodhi poshtë padinë, si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

14. Lidhur me kërkesëpadinë e Paditësit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 10/K-56-20 të datës 21.07.2020 me nr. prot. 05-3484/3 të Kryeinspektorit Shëndetësor gjykata gjeti se kërkesëpadia e është e bazuar.
15. Gjykata rikujton se Kryeinspektori Shëndetësor përmes vendimit nr. 10/K-56-20 të datës 21.07.2020 me nr. prot. 05-3484/3 e kishte refuzuar ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e Inspektoratit Farmaceutik. Në arsyetim të atij vendimi Kryeinspektori Shëndetësor e ka përshkruar procedurën sipas mjetit juridik të goditjes dhe i ka përsëritur gjetjet dhe arsyet e Inspektoratit Farmaceutik. Në këtë vendim nuk është arsyetuar lartësia e gjobës së shqiptuar. Përveç kësaj, në vendim askund nuk janë dhënë sqarime lidhur me pretendimet ankimore të Paditësit.
16. Për gjykatën, ky arsyetim është i mangët dhe në bazë të tij është e pamundshme që të kuptohen arsyet se pse është vendosur si në dispozitiv të atij vendimi. Sipas nenit 48 para. 1 të LPPA-së “Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”, ndërsa sipas para. 2 të po të njëjtit nen “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Në anën tjetër, neni 134 para. 1 i LPPA-së ka paraparë se “Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë”.
17. Siç vërehet, LPPA-ja me qëllim që pala ta kuptojë aktin administrativ ka vendosur standarde strikte lidhur me arsyetimin e akteve administrative, të cilat zbatohen edhe në procedurën sipas ankesës në organin administrativ të shkallës së dytë. Sipas dispozitave të cekur më lartë, në arsyetim duhet të tregohet baza ligjore e vendimit dhe arsyet e zbatimit të asaj baze ligjore. Gjithashtu, në vendim duhet të jepen arsyet se pse

pretendimet e caktuara të palës nuk janë pranuar, e sidomos në rastin e aktit administrativ, i cili e zgjidh ankesën e palës.

18. Për këtë gjykatë, nga arsyetimi i vendimit nr. 10/K-56-20 i datës 21.07.2020 me nr. prot. 05-3484/3 të Kryeinspektorit Shëndetësor nuk mund të kuptohet se pse është caktuar gjoba në lartësi prej 1000€. Sipas nenit 37 para. 3 të LPPM-së *“Inspektorati farmaceutik mund të shqiptoj gjoba në vlerë deri në njëmijë (1.000) euro”*, që nënkupton se me LPPM shuma e gjobës prej 1000€ është caktuar si shumë maksimale, por nuk ka pengesë që të caktohet ndonjë shumë më e vogël, rrjedhimisht Inspektorati Farmaceutik me rastin e shqiptimit të gjobës duhet të vlerësoj peshën e shkeljes së konstatuar dhe në bazë të asaj të caktoj lartësinë e gjobës. Në rastin konkret, Inspektorati Farmaceutik ka shqiptuar gjobë në lartësinë maksimale të lejuar, ndërsa nga arsyetimi nuk rrjedh se Inspektorati Farmaceutik e as Kryeinspektori Shëndetësor kanë bërë ndonjë vlerësim të peshës së shkeljes së konstatuar dhe gjobës së shqiptuar. Në këtë drejtim gjykata sqaron se Kryeinspektori Shëndetësor, si organ epror për shqyrtimin e ankesës, ka pasur kompetencë që ta vlerësoj arsyetimin e aktit të ankimuar dhe të jap arsyetim të plotë, siç i ka mundësuar neni 132 para. 1 i LPPA-së, sipas të cilit *“Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, për arsytet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar”*
19. Përveç kësaj, edhe fakti që Kryeinspektori Shëndetësor në vendimin e tij nuk ka paraqitur pretendimet e ankimore të Paditësit e as nuk i ka trajtuar ato, për këtë gjykatë paraqet shkelje të nenit 134 para. 1 të LPPA-së.
20. Siç është cekur më lartë, akti administrativ i shkallës së dytë asnjërin nga këto kërkesat ligjore nuk i ka plotësuar, rrjedhimisht është i barabartë me një akt administrativ që nuk ka fare arsyetim. Si i tillë, është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 para. 1 nënpara. 1.4 të LPPA-së, sipas të cilit *“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: (...) 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ”*.
21. Gjykata rikujton se, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë, siç parasheh neni 44 para. 1 i LKA-së, ndërsa për nulitetin (paligjshmërinë) e aktit administrativ

gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, siç urdhëron neni 44 para. 2 i LKA. Kjo nënkupton se, gjykata e shqyrton ligjshmërinë e aktit administrativ të goditur edhe për arsye të cilat paditësi nuk i nga ngritur para gjykatës.

22. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se për shkak të metave të cekura më lartë e pati juridikisht të pamundshme që t'i vlerësoj pretendimet e Paditësit për gjendjen faktike, rrjedhimisht e pati të pamundur të vendos me juridiksion të plotë në kuptim të nenin 43 para. 3 të LKA-së.
23. Për këto arsye, gjykata e anuloi aktin administrativ nr. 10/K-56-20 të datës 21.07.2020 me nr. prot. 05-3484/3 të Kryeinspektorit Shëndetësor dhe meqenëse karakterit i çështjes konkrete është i tillë që duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ të nxirret një tjetër, atëherë gjykata e obligoi të Paditurin si organ administrativ i shkallës së dytë që jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e dërgimit të këtij aktgjykimit ta nxjerr aktin e ri administrativ dhe t'ia dërgoj Paditësit si palë ankuese.

IV. Udhëzimet për organin administrativ në ri procedurë.

24. Në ri procedurë Kryeinspektori Shëndetësor si organ administrativ i shkallës së dytë duhet ta rivlerësoj ankesën e Paditësit dhe të nxjerrë akt administrativ të ri në përputhje me dispozitat LPPA-së. Konkretisht, ai me rastin e hartimit të aktit të tij administrativ duhet t'i merr parasysh pretendimet ankimore të Paditësit si palë ankuese dhe të jap sqarime lidhur me pretendimin e Paditësit se inspektimi është bërë jashtë orarit të punë, të sqaroj në bazë të cilave dispozita e ka vlerësuar aktin administrativ të shkallës së parë dhe pse pikërisht ato dispozita ligjore është dashur të zbatohen. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se i organi administrativ i shkallës së dytë i ka të gjitha kompetencat nga neni 132 i LPPA-së në ri procedurë.
25. Përveç kësaj, Kryeinspektori Shëndetësor duhet të jap arsyetim se në bazë të cilave kritere ligjore është përcaktuar lartësia maksimale e gjobës prej 1000€ dhe pse ndonjë shumë tjetër më e vogël nuk ka mundur ta arrij qëllimin e gjobës.
26. Gjykata sidomos rikujton se Kryeinspektori Shëndetësor me rastin e nxjerrjes së aktit të ri administrativ është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, siç e ka paraparë neni 65 i LKA-së.

V. Shpenzimet e procedurës

27. Paditësit me padinë e tij kishte kërkuar që i padituri i parë t'ia paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës në këtë konflikt administrativ. Gjykata vendosi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale në bazë të nenit 64 të LKA-së.
28. Për arsyet e cekura më lartë, duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 të LKA-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.487/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimi. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.